

LIGJ
Nr. 71/2019

PËR KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare (në vijim Korporata), si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj.

Neni 2
Objektivat e Korporatës

Korporata ka këta objektiva kryesorë:

1. Nxiti zhvillimin ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
2. Vënien në përdorim më eficiencë të pronave shtetërore.
3. Kryerjen e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat.

Neni 3
Parimet e përgjithshme

1. Në përmbushjen e funksioneve të saj, Korporata udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:
 - a) përparësia e zhvillimit ekonomik në nivel qendror, vendor dhe rajonal, si dhe lidhjen me politikat shtetërore të zhvillimit;
 - b) pavarësia në vendimmarrje, në kryerjen e funksioneve, në propozimin dhe zbatimin e projekteve;
 - c) përfitueshmëria, fizibiliteti ekonomik dhe tregtar i projekteve;
 - ç) trajtimi në mënyrë të drejtë dhe të barabartë i palëve me të cilat bashkëpunon;
 - d) ruajtja dhe zhvillimi i vlerës së aseteve;
 - dh) zbatimi me efektivitet, eficiencë, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave;
 - e) nevojshmëria dhe proporcionaliteti në marrjen e masave për realizimin e objektivave;
 - ë) respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, në procedura dhe treg, në përputhje me kuadrin ligjor mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore;
 - f) zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;
 - g) integriteti dhe ndalimi i konfliktit të interesave në kryerjen e funksioneve dhe marrëdhëniet me partnerët dhe palët e treta;
 - gj) përgjegjësia ndaj palëve të interesuara dhe partnerëve;

- h) përgjegjësia për zhvillimin e politikave sociale.
2. Përveç parimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, Korporata udhëhiqet edhe nga parime e kritere të tjera, të përcaktuara në statut dhe në aktet e tjera të saj, si dhe në marrëveshjet respektive me institucionet dhe/ose palët e treta.

Neni 4

Statusi juridik

1. Korporata krijohet si person juridik, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe këtij ligji.
2. Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Korporatës është ministri përgjegjës për ekonominë.
3. Institucionet financiare ndërkombëtare të zhvillimit mund të zotërojnë aksione të Korporatës. Procedurat, kriteret dhe formula e pjesëmarrjes së institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Korporata ka stemën, logon, dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës.
5. Korporata ka selinë në Tiranë dhe ka të drejtën të krijojë struktura të tjera, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Funksionet e Korporatës

- Funksionet kryesore të Korporatës janë:
1. Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave dhe projekteve në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
2. Këshillimi i institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin, dhe rekomandimin e projekteve.
3. Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e tyre.
4. Me autorizim të Këshillit të Ministrave, merr rolin e zhvilluesit, sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik.
5. Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Burimet financiare

1. Korporata mund të financohet nga:
- a) buxheti i shtetit për kapitalizimin e saj;
 - b) kontributi i institucioneve financiare ndërkombëtare;
 - c) të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara;
 - ç) donacionet në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - d) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e saj të brendshme.
2. Financimi i Korporatës nga buxheti i shtetit do të jetë në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.
3. Detyrimet financiare të Korporatës nuk i transferohen buxhetit të shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i Korporatës.

Neni 7

Transferimi i pronave shtetërore

1. Prona shtetërore, në kuptim të këtij ligji, janë pronat e luajtshme, të paluajtshme shtetërore, të drejtat reale mbi to, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore. Kur Korporata identifikon prona shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi, i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë, transferimin e tyre te Korporata. Me transferim kuptohet kalimi i së drejtës së përdorimit dhe/ose i së drejtës së pronësisë të pronave shtetërore nga pushteti qendror ose vendor te Korporata.

2. Kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës, e cila ka kaluar te Korporata, sipas pikës 1, të këtij neni, me qira, enfiteozë, *leasing*, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral, ose të përdorimit në forma të tjera, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II MASA MBËSHTETËSE

Neni 8

Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse

1. Për zhvillimin dhe zbatimin e një projekti investimi, Korporata mund të mbështetet nga institucionet shtetërore me infrastrukturë ndihmëse, të tilla si: rrugë, ujësjellës, kanalizime, energji elektrike dhe telekomunikacion.

2. Korporata kontribuon proporcionalisht ose sipas mundësive në realizimin e infrastrukturës ndihmëse.

3. Ministria përgjegjëse për ekonominë, në bashkëpunim me ministrinë e tjera, shqyrton dhe verifikon nevojat e kërkesat për infrastrukturë ndihmëse, si dhe vlerëson koston e përafërt për realizimin e saj, kosto kjo që nuk duhet të jetë disproporcionalisht e lartë, në raport me vlerën dhe rëndësinë e projektit të investimit. Në rast se kërkesa për mbështetje me infrastrukturë ndihmëse vlerësohet pozitivisht, ministria përgjegjëse për ekonominë përgatit dokumentacionin e nevojshëm.

4. Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

Neni 9

Marrja e licencave/lejeve

Për marrjen e licencave/lejeve, pas dorëzimit të dokumentacionit nga Korporata, institucionet/entet/autoritetet publike, brenda 15 ditëve pune, kthejnë përgjigje mbi kërkesën për miratim të licencave/lejeve, sipas legjislacionit në fuqi. Përgjigjet, për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave/lejeve, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohore prej 30 ditë pune.

Neni 10

Regjimi i prokurimit

1. Për kontratat publike, të cilat financohen plotësisht nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, zbatohen rregullat e prokurimit që parashikohen nga kjo organizatë ose institucion. Në rastin e kontratave publike që bashkëfinancohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit.

2. Për kontratat publike, të cilat financohen nga buxheti i shtetit, zbatohen dispozitat e ligjit për prokurimin publik në fuqi.

KREU III STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 11

Organet drejtuese të Korporatës

Organet e Korporatës janë:

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Këshilli Mbikëqyrës.
3. Drejtori Ekzekutiv.
4. Bordi Këshillimor.

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja merr vendime për çështjet e mëposhtme:

1. Miratimin e statutit të Korporatës dhe ndryshimeve të tij.
2. Miratimin e strategjisë së Korporatës.
3. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecursisë së veprimtarisë së Korporatës.
4. Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës, përveç atyre që i janë dhënë me këtë ligj Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 13

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5, ku shumica janë të pavarur.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe lirohen nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Korporatën.
4. Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen ata persona që:
 - a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotërojnë të paktën “master shkencor” ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) kanë shtetësi shqiptare ose të huaj.
5. Shpërblimi për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës nuk është më pak se 1/3 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 14

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës siguron që Korporata gëzon autonomi operationale në veprimtarinë e saj dhe ka këto kompetenca:
 - a) propozon për miratim pranë Asamblesë statutin e Korporatës dhe ndryshimet në të;
 - b) propozon për miratim pranë Asamblesë strategjinë e Korporatës;
 - c) miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;

- c) miraton projektet e investimit;
 - d) miraton ngritjen e strukturave të tjera të Korporatës;
 - dh) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;
 - e) miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;
 - ë) kujdeset që Korporata të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - f) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecuresë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Korporata;
 - g) siguron që auditimi i Korporatës kryhet të paktën një herë në vit;
 - gj) emëron dhe liron Drejtorin Ekzekutiv;
 - h) përcakton pagat dhe shpërblimin e organeve dhe administratës së Korporatës;
 - i) krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në Korporatë;
2. Këshilli Mbikëqyrës miraton procedurat dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve.
3. Këshilli Mbikëqyrës bashkëpunon me Bordin Këshillimor në marrjen e vendimeve.
4. Këshilli Mbikëqyrës përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës.

Neni 15

Drejtori Ekzekutiv

- 1. Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Korporatës.
- 2. Drejtori Ekzekutiv përgjigjet përpara Këshillit Mbikëqyrës.
- 3. Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe lirohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Kushtet, afatet dhe rregullat e emërimit, performancës dhe lirimit përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës dhe në kontratën me Drejtorin Ekzekutiv.
- 4. Drejtor Ekzekutiv emërohet personi që:
 - a) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotëron të paktën “master shkencor” ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) është shtetas shqiptar ose i huaj.
- 5. Paga e Drejtorit Ekzekutiv është konkurruese në raport me tregun, kredencialet dhe performancën në detyrë.

Neni 16

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

- 1. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë dhe detyrohet, por pa u kufizuar:
 - a) të administrojë veprimtarinë e Korporatës;
 - b) të përfaqësojë Korporatën në marrëdhënie me të tretët;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Korporatës;
 - ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;
 - d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën e Korporatës;

dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Korporatës, sipas legjislacionit në fuqi;

e) të raportoje përpara Këshillit Mbikëqyrës dhe Bordit Këshillimor për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;

ë) të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, legjislacionit dhe akteve të brendshme të Korporatës.

2. Drejtori Ekzekutiv bashkëpunon me Bordin Këshillimor për të propozuar projekte investimi për miratim në Këshillin Mbikëqyrës.

3. Drejtori Ekzekutiv përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj, detyra të tjera që kryen administratori, sipas përcaktimeve të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës.

Neni 17

Bordi Këshillimor

1. Bordi Këshillimor përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Tre anëtarë përfaqësojnë institucionet qendrore, dy anëtarë janë nga institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe katër anëtarë të tjerë janë të pavarur.

3. Anëtarët e Bordit Këshillimor zgjidhen ata persona që:

a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;

b) zotërojnë të paktën “master shkencor” ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;

c) kanë shtetësi shqiptare ose të huaj.

4. Bordi Këshillimor ka funksion këshillues në raport me Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv.

5. Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori Ekzekutiv kanë për detyrë informimin dhe bashkëpunimin me Bordin Këshillimor mbi iniciativat, projektet e propozuara për Korporatën dhe aktivitetet e tjera të saj.

6. Bordi Këshillimor rregullisht informon Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv mbi zhvillimin dhe zbatimin e planit të punës së Korporatës.

7. Bordi Këshillimor mund të krijojë komitete të specializuara për të kryer detyrat e tij.

8. Rregullat e funksionimit të Bordit përcaktohen në statutin e Korporatës dhe aktet e brendshme të saj.

9. Shpërblimi për anëtarin e Bordit Këshillimor nuk është më pak se 1/4 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 18

Administrata

1. Struktura dhe organika e Korporatës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

2. Marrëdhëniet e punës së personelit të Korporatës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Korporatës.

KREU IV

KONTABILITETI DHE AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 19

Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore

1. Korporata mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 20

Auditimi i pasqyrave financiare

1. Auditimi i pasqyrave financiare të Korporatës kryhet sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar, si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

2. Këshilli Mbikëqyrës krijon një komitet të specializuar për auditimin financiar, me anëtarë dhe ekspertë të pavarur. Rregullat specifike për krijimin dhe funksionimin e komitetit të auditit përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit kryen auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomikë dhe financiarë të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 2, të këtij ligji.

Neni 22

Dispozita kalimtare

Ministria përgjegjëse për ekonominë, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme për:

1. Sigurimin e kapitalit fillestar;
2. Zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Korporatës;
3. Miratimin e statutit të Korporatës;
4. Regjistrimin e Korporatës pranë regjistrisë tregtare.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.10.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

